



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK**

UDHËZUES

**PËR PLOTËSIMIN E DOSJES SË APLIKIMIT PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË
“PROFESOR” DHE “PROFESOR I ASOCIUAR”**

Dosja duhet të përmbajë dokumentet, sipas kësaj renditje, me numërat perkatës, si në hard copy dhe në CD ose Memory Stick (çdo dokument format pdf, i emërtuar):

- **Dok. Nr. 1-** Formularin e kërkesës sipas formatit të miratuar nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik;

Nëse kandidati kërkon ekuivalentim të veprimtarive akademiko – didaktike, të monografisë apo të post doktoraturës, ai duhet ta specifikojë këtë në kërkesën që i dorëzon drejtuesit të njësisë kryesore së bashku me dosjen, në momentin e aplikimit.

Gjithashtu në rastin e kërkesës për ekuivalentim (kur paraqet monografi dhe veprimtari akademiko – didaktike) ai duhet të përcaktojë qartë dhe në mënyrë të detajuar llojin e ekuivalentimit, që kërkon të përfitojë;

Në momentin e dorëzimit të dosjes pranë Njësies Kryesore, kandidati pajiset me një dokument të protokolluar që vërteton datën e dorëzimit. Një kopje e këtij dokumenti futet në dosje.

- **Dok nr. 2.-** CV e aktualizuar deri në momentin e aplikimit, në formatin Europass;
- **Dok nr. 3. -** Fotokopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës. Nëse kandidati ka ndërruar mbiemrin dhe paraqet në dosje punime me mbiemrin para martesë dhe me mbiemrin pas martesë atëherë ai duhet të paraqesë dhe certifikatë martesë;
- **Dok. Nr. 4.-** Vërtetimin e dëshmisë së gjuhës së huaj;
- **Dok. Nr. 5. -** Vërtetimin e punësimit aktual, lëshuar nga Institucioni përgjegjës, nëpërmjet titullarit;
- **Dok. Nr. 6. –Zëri vërtetime mësimdhënie duhet të përmbajë:**

a) Vërtetimin për mësimdhënie, sipas afateve kohore të parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi, lëshuar nga Institucioni dhe

b) Vërtetimin nga institucioni për statusin e titullarit të lëndës kur kandidati aplikon për fitimin e titullit akademik “Profesor” ose

c) Vërtetimin nga institucioni që kandidati ka zhvilluar cikle të plota leksionesh kur ai aplikon për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”;

- **Dok. Nr. 7.- Zëri -Udhëheqje doktorate duhet të përmbajë:**
 - Vërtetim për udhëheqjen e doktoratave në rastin e aplikimit për titullin akademik “Profesor”.
 - Në rastin e bashkëudhëheqjes kandidati duhet të paraqesë vërtetim mbi këtë bashkë udhëheqje doktorate, ku të specifikohen të dhënat e personelit akademik të kategorisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

"Profesor" bashkëudhëheqës si dhe të dhënat e Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) brenda ose jashtë vendit dhe kopje e marrëveshjes dypalëshe mbi të cilën është bazuar bashkëudhëheqja e doktoratës.

• **Dok. Nr. 8- Zëri – Doktorata; Titulli Prof. i Asoc., duhet të përmbajë:**

- Kopje të noterizuar të diplomës së gradës shkencore "Doktor" në rastin e aplikimit për titullin akademik "Profesor i Asociuar" ose
- Kopje të noterizuar të diplomës së gradës shkencore "Doktor" dhe titullit akademik "Profesor i Asociuar" në rastin e aplikimit për titullin akademik "Profesor".

Nëse kandidati ka përfunduar studimet e doktoraturës jashtë vendit atëherë diploma e doktoratës duhet shoqëruar dhe me njëhsimin përkatës nga MAS;

• **Dok. Nr. 9. – Zëri - Botime të artikujve shkencorë.**

Artikujt të ndahen në tre seksione.

- **Seksioni i parë:** Artikuj të botuar në Revista të indeksuara në Scopus/Web of Science;

Per revistat e indeksuara ne Scopus, me indikatorët përkatës te citimit, dokumentimi për secilin artikull duhet të ketë si në dosjen fizike ashtu dhe në atë elektronike si faqe të parë evidencën e nxjerrë nga scopus author për kandidatin dhe artikullin në fjalë dhe më pas punimin e plotë të bashkëlidhur të nxjerrë nga Revista në të cilën është botuar. Duhet të rezultojnë të qarta dhe të dhënat e Revistës së indeksuar në Scopus.

Për revistat e indeksuara në Web of science dokumentimi për secilin artikull duhet të ketë si në dosjen fizike ashtu dhe në atë elektronike si faqe të parë evidencën e nxjerrë nga Web of science për kandidatin dhe për artikullin në fjalë dhe më pas punimin e plotë të bashkëlidhur të nxjerrë nga Revista në të cilën është botuar. Duhet të rezultojnë të qarta dhe të dhënat e Revistës së indeksuar në Web of Science.

- **Seksioni i dytë:** Artikuj të botuar në Revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara. Dokumentimi për secilin artikull duhet të ketë si në dosjen fizike ashtu dhe në atë elektronike si faqe të parë dëshminë e indeksimit të revistës ndërkombëtare dhe më pas punimin e plotë të bashkëlidhur të nxjerrë nga Revista në të cilën është botuar. Duhet të rezultojnë të qarta të gjitha të dhënat e Revistës ndërkombëtare të indeksuar. Në skedë duhet plotësuar zëri “indeksimi” me linkun e revistës ku gjenden të dhënat e saj mbi indeksimin.

- **Seksioni i tretë:** Artikuj të botuar në Revista shkencore kombëtare. Dokumentimi për secilin artikull duhet të ketë punimin e plotë të bashkëlidhur të nxjerrë nga Revista në të cilën është botuar. Duhet të rezultojnë të qarta të gjitha të dhënat e Revistës kombëtare;

Të përgjithshme mbi paraqitjen e artikujve:

- Brenda secilit seksion artikujt duhen numëruar sipas radhitjes në skedën e kandidatit.(Artikulli nr.1-Scopus/Web of science, nr.2...e kështu me rradhë).
- Duhet dorëzuar gjithashtu në formatin Word një përmbledhje me link-un përkatës të aksesueshëm, dhe me renditje autorësh dhe me të gjitha të dhënat sipas skedës, sipas numrave rendor të shoqëruara me linqe të aksesueshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

• **Dok. Nr. 10 – Zëri - Referime në konferencat shkencore.**

Çdo referim konference duhet shoqëruar me dokumentin përkatës që vërteton pjesëmarrjen në këtë konferencë si programin, dëshminë e referimit në konferencë (certifikatë) dhe botimin në proceedings, me ISBN/ISSN, e shoqëruar me dokumentet origjinale ose fotokopje; Çdo referim konference duhet shoqëruar me punimin e plotë. Në skedë duhen plotësuar zërat përkatës dhe kandidati duhet të sigurohet që linku përkatës të jetë i aksesueshëm. Si në skedë ashtu dhe në materialet e skanuara duhet të jetë i evidentuar vendi i mbajtjes së Konferencës kombëtare apo ndërkombëtare, data e organizimit të saj, të dhënat mbi indeksimin me kod ISBN/ISSN kur punimi është botuar në Proceedings. Referimet e konferencave në Cd/memory stick duhet të jenë në një zë më vete “konferenca”, të ndarë në dy seksione: “Konferenca shkencore ndërkombëtare në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës” dhe “Konferenca të tjera shkencore”. Brenda secilit seksion konferencat duhen numëruar sipas rradhitjes në skedën e kandidatit. (Konferenca nr.1, nr.2...e kështu me rradhë). Edhe në skedë shënohen fillimisht konferencat e seksionit të parë dhe më pas konferencat e seksionit të dytë.

Duhet dorëzuar gjithashtu në formatin Word një listë e referimeve në formën e një përmbledhjeje me link-un përkatës të aksesueshëm, dhe me renditje autorësh, të paraqitura sipas numrave rendor të plotësuar në skedë.

• **Dok. Nr. 11. – Zëri -Monografia ose monografite (kur kërkohet ekuivalentimi) do të përmbajë:**

- Dokumentin që vërteton se monografia përmbush kushtet e origjinalitetit;
- Vlerësimet në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) Profesorë vlerësues të pavarur të fushës kërkimore shkencore nga të cilët, të paktën njëri prej tyre është nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës.
- Vendim që Monografia është pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit.
- Dokumentin që vërteton rankimin e shtëpisë botuese nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D në rastin e monografive të botuara jashtë vendit;
- Nëse kandidati kërkon ekuivalentim të monografisë ai duhet të paraqesë kërkesë për ekuivalentim në formularin e kërkesës dhe në skedë duke specifikuar llojin e ekuivalentimit që kërkon të përfitojë. Departamenti duhet të shprehet për ekuivalentimin e monografisë në relacionin e tij.
- Në skedë duhet të specifikohen të dhënat e autorit/autorëve, titullit dhe link-ut të aksesueshëm (nëse ka). Duhet dorëzuar dhe botimi/botimet origjinale ose një fotokopje e monografisë.

• **Dok. Nr. 12 - Zëri – Angazhime dhe veprimtari akademiko – didaktike** pas marrjes së gradës shkencore “doktor”, në rastin e aplikimit për titullin akademik “Profesor i Asociuar” ose pas fitimit të titullit “profesor i Asociuar” në rastin e aplikimit për titullin “Profesor”

- Lista e pjesëmarrjes në aktivitetet e mëposhtme, e shoqëruar me dokumentet si vijon më poshtë, për secilin zë. Mosdorëzimi i plotë i dokumenteve për veprimtaritë e mëposhtme nuk do mundësojë aplikimin e ekuivalentimeve.
- Secila veprimtari e përshkruar në Manualin e ekuivalentimeve të veprimtarive akademiko – didaktike dhe në këtë udhëzues duhet të vlerësohet nga Njësia bazë ku aplikon kandidati, e cila duhet të vlerësojë dhe të shprehet qartë në vendimin e saj mbi secilën veprimtari të zhvilluar nga kandidati dhe për mundësinë e aplikimit të ekuivalentimit të kërkuar.

(a) pjesëmarrja në komitete shkencore apo redaktuese - duhet të dorëzohen:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

- Vërtetim i institucionit përgjegjës për organizimin e konferencës për pjesëmarrjen e kandidatit në komitete shkencore apo redaktuese të konferencave shkencore kombëtare/ndërkombëtare, të zhvilluara në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, ku të specifikohet që kandidati ka vlerësuar, redaktuar apo kryer peer review për secilën konferencë.
 - Vërtetimi shoqërohet me produktet e redaktimit apo peer review, që ka kryer kandidati.
- (b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose jo periodikeve shkencorë kombëtarë/ndërkombëtare- duhet të dorëzohen:**
- Vërtetim i organit përgjegjës drejtues të periodikut apo jo periodikut që specifikon vlerësimet apo redaktimet që kandidati ka kryer si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose jo periodikëve shkencorë kombëtare.
 - Vlerësimet apo redaktimet që kandidati ka kryer.
- (c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar- duhet të dorëzohen:**
- Vërtetim i njësisë apo njësive që kanë organizuar projektin për angazhimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore-shkencore, kombëtare/ndërkombëtare në nivel drejtuesi apo koordinatori si dhe anëtar;
- (d) përfitim të financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar - duhet të dorëzohen:**
- Dokument i lëshuar nga financuesi ose përfituesi i financimit, për rolin organizator dhe drejtues të kandidatit;
- (e) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin në rolin e koordinatorit të projektit - duhet të dorëzohen:**
- Dokumentin e lëshuar nga donatori i huaj ose përfituesi i financimit për rolin e kandidatit si koordinator **të projektit kombëtar ose ndërkombëtar,**
 - Vlerësimin e njësisë bazë/kryesore ku aplikon kandidati, mbi përfitimin institucional nga ky projekt dhe rolin e kandidatit në të.
- (f) pjesëmarrja në vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare - duhet të dorëzohen:**
- Vërtetimi përkatës i financuesit të projektit për këtë vlerësim,
 - Vlerësimi që ka kryer kandidati;
- (g) pjesëmarrja dhe angazhimi si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare/ndërkombëtare - duhet të dorëzohen:**
- Vërtetimi i institucionit organizues ku të specifikohen dhe vlerësimet/peer review që ka kryer kandidati,
 - Vlerësimi apo peer review që ka kryer kandidati.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

(h) pjesëmarrja në projektet e transferimit teknologjik të patentave - duhet të dorëzohet:

- Dokumentacioni përkatës lëshuar nga autoriteti përkatës ose vërtetimi që vërteton projektin e transferimit të teknologjisë.
- **Dok. Nr. 13 – Zëri – Post doktorata (në rastin e aplikimit për titullin Profesor i Asociuar) do të përmbajë:**
 - Dëshmi për studime post doktoratë në një nga vendet anëtare të BE, OECD ose G20, pas mbrojtjes së gradës shkencore “doktor”, deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “Profesor i Asociuar”, sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj si dhe
 - Një raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë periudhës përkatëse, të konfirmuar nga drejtuesi i studimeve post doktoratë.
 - Dokument që tregon për produktin dhe/ose rezultatin e studimeve postdoktorale të aplikantit.
- **Dok. Nr. 14- Zëri - Skeda e plotësuar nga kandidati në dy kopje.**

Njëra kopje duhet të jetë në formatin word dhe kandidati duhet të kujdeset që çdo link të jetë i aksesueshëm si dhe një kopje në formatin pdf e firmosur. Duhet të plotësohet çdo zë i skedës dhe të specifikohet qartë nëse kërkohet aplikimi i ekuivalentimeve përmes monografisë apo angazhimeve.

Shënime të përgjithshme:

Dosja e aplikantëve për titujt “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar” do të plotësohet në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzuesi.

Dosja nuk duhet të përmbajë dokumente të cilët nuk janë të nevojshme dhe nuk lidhen me kriteret për fitimin e titujve akademikë.

Kandidati duhet të paraqesë në dosje edhe pagesën e tarifës për aplikimin për titullin përkatës.

Dosja duhet të përmbajë relacionin e relatorëve të Njesisë bazë, shoqëruar me skedën përkatëse të nënshkruar, si edhe vendimin e njesisë bazë (departamentit).

Përveç dosjes së plotë fizike, kandidati dorëzon edhe dy kopje elektronike të të gjithë dokumentacionit, të regjistruara në dy CD ose në dy memory stick, apo në ndonjë mjet tjetër të ruajtjes elektronike të të dhënave.

Një kopje elektronike e dosjes arkivohet në njësinë bazë që ka bërë vlerësimin, ndërsa kopja tjetër është pjesë përbërëse dhe ruhet në dosjen e kandidatit.